



Letrat e Arbërit

LIBËRI RI

100 personalitetet e gomarit të madh

nga
**Xhafer
MARTINI**

Faqe 2



TRADITA POPULLORE

Alegoria nga Dibra

nga
**Mevlud
BUCI**

Faqe 3



TREGIM

Shejf e shkruej!

nga
**Ahmet
KAMBERI**

Faqe 4, 5



POEZI

Gjurmë në fjalë

nga
**Avni
NDREU**

Faqe 6



KRITIKË LETRARE

Setki Jashari – poeti i dashurisë

nga
**Halil
RAMA**

Faqe 7




Përgatiti: Miranda Goleci
Ky numër i suplementit u bë i mundur
me mbështetjen e Botimeve M&B
(botimemb@gmail.com)

Çarku

TREGIM

nga **Artan Gj. Hasani**



“Ke përdhosur simbolin e lirisë së qytetit!”.

Veç këtë fjali kishte mbajtur mend nga aktakuza e gjatë e prokurorit. Kishte bërë plot pesë vjet burg për përmjerjen që në dehje e sipër i kishte bërë publikisht një statujë që simbolizonte Lirinë e Qytetit, pikërisht në çastin e inaugurimit të saj nga kryebashkiaku. Pesë vjet nën vështrimin dhe vëmendjen e syrit të gardianëve.

Pasi doli nga burgu e ndjente se përsëri ishte nën vëmendjen jo vetëm të policëve, por edhe të qytetarëve. Qyteti tij që shquhej si qytet liridashës, nuk mund ta harronte lehtë atë. I dukej sikur të gjithë e tregonin me gisht... “Ja, ai, përdhosësi i Lirisë!”. Por jeta vazhdonte të rridhte dhe vëmendja e njerëzve ia la vendin indiferencës, indiferenca injorimit, dhe një ditë atë e harruan. Askush nuk e njihte më. Askush nuk donte t’ia dinte më për të.

Banonte në derën ngjitur me mua. Jetonte vetëm. Gjithnjë i dehur dhe i palarë. Askush nuk ia dinte emrin. Nuk i fliste askujt. Nuk punonte. E siguronte jetesën nga shitja e zogjve dhe pëllumbave.

Ditën e parë që nisa të jetoja në atë pallat, shumë vjet më parë, duke dashur të njihja fqinjin tim, kisha trokitur në derën e tij. Dera ishte hapur duke më sjellë në hundë një erë të rëndë që vinte nga brenda shtëpisë. Para meje ish shfaqur ai. I pistë, me flokët e gjatë të pakrehur e me një vështrim prej të shkalluari.

Nën sytë e çakërditur i dalloheshin lehtësisht qeset e varura si dëshmi të pagjumësisë, lodhjes dhe dehjes. Papritur pas shpinës së tij, mbi supe, ishin vërsulur drejt meje një mori zogjsh dhe pëllumbash nga të gjithë racat. Duke klithur, kënduar dhe duke rrahur fort flatrat dhe krahët e tyre ata mbushën për një çast korridorin e gjatë të pallatit dhe duke lënë në ajër puplat e tyre u rikthyen përsëri brenda asaj shtëpie të panjohur për këdo.

Më vonë nuk merrej më me pëllumbat dhe kanarinat, por me zogj të egër pylli, ca fluturakë të vegjël që i quajnë kryearëza. Kryearëza është një zog liridashës që e urren kafazin më shumë sesa kanarina apo papagalli. Jo shumë këngëtar, por liridashës. Dilte që në mëngjes me një çark në xhepat e grisur të xhakëtës tërë zhul dhe merrte rrugën drejt shinave të trenit që të çonin drejt pyllit të vetëm të qytetit.

Dikur kisha parë pakëz të hapur derën e tij. Kisha trokitur dhe, pasi askush nuk i ish përgjigjur trokitjes sime, kisha shtyrë derën e rrjepur e të palyer prej shumë kohësh dhe isha gjendur në një sallon të errët që kutërbonte nga një erë glasash dhe vjetërsirash. Një derë dhome u hap dhe duke më bërë shenjë me dorën në buzë që të heshtja, fqinji misterioz më ftoi brenda.

Nuk do ta kisha besuar që në atë ambient të qelbur mund të jetonte një krijesë njerëzore. Kudo nëpër mure syri të zinte kafazë të vjetër e të ndryshkur, me portat e shqyera e të varura nëpër tela... Një mbeturinë qilimi e mbushur plot me glasa dhe njolla balte të tharë. Në cep të saj një komerdare e zezë plot mballoma që mesa kuptova i shërbente si jastëk fqinjit tim. Një batanije vrima-vrima varej mbi një kafaz pranë dritares, e cila në vend të xhamave kishte ca kompensata të çara nga të cilat depërtonte një rreze e hollë drite. Po të mos ishin ato të çara, vështirë se mund të kuptoje që jashtë ishte ditë.

Në tërë atë apartament të mbushur plot e përplot me kafazë ndodhej veç një zog. Një kryearzë. Çuditërisht e pastër, me atë shkëlqim të puplave dhe pendëve të veta... me atë gri dhe të zezë spërkatur me pikla të verdha nën një tis të kuqërremtë... Ai, i pistë dhe i palarë si gjithnjë, më hodhi një vështrim ku buhavitja e syve dhe sklepat mbi qerpikët e errët nuk më penguan të dalloja një ndriçim dinak... diçka si mburrje... si entuziazëm... Edhe zogu kishte kthyer kokën e tij nga unë... si i tulatur nga vizita e një njeriu tjetër në atë banesë që mesa dukej ishte veç pronë e atyre të dyve. Përsëri gisht i tij mbi buzë dhe vështrimi iu përqendrua te porta e mbyllur e kafazit. Tashmë vështrimi i syve të kryearëzes kishte rënë mbi të. Në dhomë nuk pipëtinte asgjë. Dukej sikur gjithçka kishte ngrirë. Papritmas, me një lëvizje të beftë dora e tij e stërvitur hapi portën e kafazit dhe në fraksione të sekondës zogu doli dhe nisi të fluturojë nëpër dhomë, një fluturim që, më shumë sesa arratisjes, i kishte ngjasuar një shëtitjeje lozonjare të ndërprerë për pauza të vogla mbi kafazët e boshatisur të varur mureve.

Papritur, nga poshtë një minderi të vjetër e të leckosur, ai nxori një çark në të cilin ish vënë një copëz buke. E vuri në mes të dhomës dhe me një lëvizje të fortë të dorës më shtyu mua jashtë dhomës dhe, pasi doli edhe vetë, mbylli derën aq sa të mund të vrojtonte çarkun dhe një orë të vjetër dore që e mbante në xhepin e grisur. Ndërsa unë akoma nuk e kisha marrë veten nga habia, pashë se si ai në dorë mbante edhe një bllok të lerosur në të cilin kishte disa shënime pothuajse të palexueshme në atë errësi që mbulonte atë apartament... Pas disa minutash, tik-takun ritmik të akrepave të orës së vjetër e kishte ndërprerë kërcitja karakteristike e çarkut.

Me një ngazëllim të paparë ai u vërsul brenda dhomës dhe në vend që të shkonte drejt çarkut ku përpëlitej kryearëza, u ul mbi minder dhe me një mbeturinë lapsi shënoi diçka në bllok dhe më pas më hodhi një vështrim triumfues, duke ma tundur bllokun dhe orën e vjetër para syve... (Vijon në faqen 5)



Gomari i Madh në vendlindje

fragment nga romani

100 personalitetet e gomarit të madh

XHAFAER MARTINI

Roman

Botimet M&B
ISBN: 978-9928-353-93-1
Faqe: 104
Çmimi: 600 lekë



Gomari i Madh kërkoi karakteristikën në mbledhjen e përgjithshme të gomerëve të fshatit të lindjes.

- Tani u kujtove ti për fshatin tënd të lindjes? - e pyeti një gomaricë plakë Gomarini e Madh dhe shtoi:

- Ke njëzet vjet që nuk ke shkelur këtu. Nëna dhe babai të vdiqën pa u qëndruar asnjë minutë te koka, kështu të vdiqën edhe dajallarët, xhaxhallarët, vëllezërit dhe kushërinjtë dhe ti nuk je dukur. As edhe një libër nuk ke ardhur ta promovosh në këtë vend të dashur ku kalove fëmijërinë.

- Ç'të vijë? - ia priti një gomar plak, - ai nuk ka shkruar as edhe dy rreshta për vendlindjen e tij. Nuk ia duam librat.

Mbasi e bënë për ujë të ftohtë me diskutime të kësaj natyre, karakteristikën ia dhanë, por të zezë, blozë, katran, duke e quajtur mendjemadh, mosmirënjohës, mospërfillës, delenxhi, homoseksual etj. Ia qëndisën e zeza mbi të bardhë. Shënuan aty edhe një rast të dyshimtë, se gjoja kishte lënë me barrë një gomaricë të re dhe nuk e kishte marrë për grua. Ia shënuan në karakteristikë edhe mospjesëmarrjen në pesëmbëdhjetëvjetorin e Shoqatës së Gomarëve të Krahinës, i shkruan se kishte qenë mësues aq i pafatë sa nxënësit nuk e linin as të japë mësim, pa bërë fjalë për cilësinë e mësimdhënies; i shkruajtën, më në fund, se si njeri me të meta fizike: pordhmadh dhe hundëtërheqës, nuk duhej të bënte pjesë në armatën e mësuesve. Figura e mësuesit është përlyer nga një si ky, prandaj duhet të ndërrojë zanat dhe të mos qaset më në asnjë shkollë.

Për Organizatën Bazë të Gomarëve të Krahinës, firma: Gomari më i Vjetër i Zonës, nderuar me medaljen Krenaria e Zonës.

Kau Zrrak nuk u habit shumë kur lexoi këtë karakteristikë. Në shumicën dërrmuese të rasteve ata të bazës kështu karakteristikash bënin për

bijtë e tyre që donin të ngjiteshin në hierarkinë diturore ose shtetërore. I tërhiqnin për t'i mbajtur dhe nuk u jepnin një të shtyrë për t'u ngjitur. Në rastin e Gomarit të Madh ajo karakteristikë mund të ishte e vërtetë, por, duke u nisur nga shumë të tjera, Kau Zrrak nuk e përfilli. Këtu duhen llogaritur edhe lutjet dhe përgjërimit e Mëshqerrës Laramane, për t'ia plotësuar dëshirën Gomarit të Madh që të jepte mësim në shkollën e Minjve të Arave. Por edhe pse e bëri këtë veprim që nga shumica e kafshëve u konsiderua në lartësinë e dinjitetit të Kaut Zrrak, ky i fundit, porositi Mëshqerrën Laramane, të cilën tashmë e kishte marrë sekretare personale, që të bënte një pyetësor për Gomarini e Madh që ky të përgjigjej me shkrim. Do të ishte një farë interviste. Kau Zrrak donte të bindej për mendjen e tij se, ashtu vesh më vesh, pëshpëritej se kjo kafshë ishte fare pa tru. Mëshqerra Laramane e përgatiti pyetësorin:

1. Çfarë kujtimesh të mira dhe të këqija ruani nga fëmijëria?
2. Kur ishit adoleshent kishit ndonjë vetëdije se çfarë mund të bëheshe në jetë?
3. Thuhet që qeniet e gjalla i shtyjnë përpara për t'u dalluar: egoizmi, interesi, urrejtja. Cila nga këto të tria të ka shtyrë përpara, apo asnjëra?
4. Keni thënë se në shkollë, sidomos në shkollën e lartë, keni qenë rebel. Përse u bërë i tillë: për të rënë në sy, për të mënjeluar ndonjë kompleks inferioriteti, për drejtësi apo për çfarë tjetër?
5. Ju lexoni, kjo dihet: po për çfarë lexoni: për të kaluar kohën, për të mësuar ose për ndonjë arsye tjetër?
6. Dashuria e xhelozia a janë si nëna dhe si bija, apo mund të ekzistojnë pa njëra –tjetrën?
7. Sinqeriteti është i shpifur apo ekziston? Po morali për çfarë i shërben qenies: për ta penguar apo për ta ndihmuar të ecë përpara?
8. Po të ishte e mundur ta fillonit jetën nga e para, do të ndiqni këtë rrugë nëpër të cilën keni ecur, apo do të ndiqni ndonjë rrugë tjetër?
9. Besoni në Zot apo jo? Si e përfytyroni Zotin?

Gomari i Madh e konsideroi provim me shkrim atë intervistë, se në fakt e tillë ishte. U futën në një sallë ku Kau Zrrak, një herë në javë mbledhte drejtorët e arsimit të rretheve dhe u mbante një fjalim të shkurtër. Vetë ulej në tryezën e madhe, në kolltuk, kurse drejtorët e arsimit në karriget që kishin në mes një tryezë shumë të gjatë në të cilën mund të zenin vend pesëdhjetë vetë. Ja, në atë tryezë, në vendin ku ulej Kau Zrrak, u ul Mëshqerra Laramane, kurse Gomari i Madh në njërin prej karrigeve në tryezën e madhe. Mëshqerra Laramane i vuri para nja dy letra të bardha format, i dha stilolapsin e vet dhe i tha të shkruante përgjigjet për secilën pyetje që i bëhej në intervistë që ishte printuar nga Laptopi i Mësherrës.

Gomari i Madhe e kuptoi se duhej marrë seriozisht puna. I tha sa kohë kishte në dispozicion për ato pyetje dhe Mëshqerra Laramane tha se për dy orë duhej të mbaronte punë, se përgjigjet duhet të ishin të shkurtra, vetëm esencë, duke iu larguar frazeologjisë boshe. Të ftoj të jesh i singertë në

përgjigje se edhe kjo do të merret parasysh. Për dy orë Gomari i Madh mbaroi punë dhe dorëzoi letrat që i kishte mbushur me shkrimin e tij garrareshur por, për çudi, të lexueshëm.

*
* *

Qs në shkollën e re Gomari i Madh nuk e ndjeu veten më mirë. Edhe aty, si në tri shkolla të tjera nuk gjeti qetësi e rehati. Drejtori i Arsimit e kuptoi se Gomari i Madh nuk kishte të dhëna për mësues. Për të mos e pushuar nga puna, e caktoi inspektor arsimi, që të kontrollonte mësuesit e tjerë. Kështu vepronte Kau Zrrak, prandaj arsimi pësoi një rënie të madhe dhe pothuaj u bë inekzistent, si në kohën kur Elefanti i Madh kishte dhënë urdhër të mbylleshin të gjitha shkollat, përveç atyre në qytete të mëdha. Por edhe si inspektor i arsimit Gomari i Madh nuk pati fare sukses. Ai zihej me mësuesit për vërejtjet e kota që bënte. Disa prej tyre i kishin dhënë një dru të mirë dhe e kishin nxjerrë nga klasa. Kau Zrrak vendosi ta pushonte dhe urdhëroi sekretaren e zyrës, Dhinë Bishtëcupë që të bënte urdhrin me shkrim. Me ardhjen e Mëshqerrës Laramane kjo kishte mbetur si sekretare e dytë e Kut Zrrak, megjithëse ishte shumë më e zonja se Mëshqerra Laramane që rrinte gjithë orarin zyrtar duke u krehur. Kur i ra shkresa në dorë, Gomari i Madh, mbasi qau tre sahatë, me lotët ende të pathara në fytyrën e tij gjatoshë, shkoi te Mëshqerra Laramane dhe iu përgjyrua që të ndërhynte te Kau Zrrak.

- Mua nuk më pyet kush, edhe pse jam sekretarja e parë e Kaut Zrrak. Shkresën nuk e kam bërë unë, por ajo tjetra, Dhia Bishtëcupë. Megjithatë, unë do ta them fjalën time.

Kau Zrrak kësaj here u tregua i vendosur dhe i tha Mëshqerrës Laramane që për këtë lutje mos t'i shkonte më në zyrë.


- Unë vij nga dashuria që kam për ty, - u përkëdhel ajo dhe la të kuptohej se kësaj here, për të prapësuar urdhrin, ajo nuk do t'i jepet vetëm përkëdhelje, por do ta linte të bënte edhe dashuri.

Kau Zrrak rezistoi shumë të mos dorëzohej para lutjeve të saj, por, më në fund, e prapësoi vendimin. Po ku ta çonte tani me punë Gomarini e Madh?! Si inspektor arsimi e kishte zëvendësuar me Kacadrenin e Verdhë që mësuesit ia kishin frikë ta kundërshtonin edhe kur nuk kishte të drejtë. Ai kishte kafshuar në buzë një mësues. Plaga nuk i ishte shëruar ende, vazhdonte të rridhte qelb. Menduan të dy me Mëshqerrën Laramane se për cilin vend pune ishte i përshtatshëm Gomari i Madh.

- E gjeta, - tha e entuziazmuar Mëshqerra Laramane, - të bëhet shef i kabinetit pedagogjik të rrethit, të merret më kualifikimin e mësuesve.

Vendi ishte bosh se Pëllumbi i Shkretëtirës, shefi i mëparshëm, kishte zënë një vend në Akademinë e Shkencave si gjeograf gjeolog. Kau Zrrak e aprovoi propozimin e Mëshqerrës Laramane.

Gomari i Madh u ndje i lumtur kur u ul në kolltukun e shefit të kabinetit pedagogjik. Këtu nuk kishte asnjë punë për të bërë. Kau Zrrak kishte ndërmend të bënte një reformë në arsim dhe se, me këtë rast, do të shkurtonte shumë vende pune. Kabineti pedagogjik nuk kishte pse të ekzistonte, por, derisa të vinte ajo ditë, le të ngrohete vezët Gomari i Madh. Aty ai nuk prishte punë se, për të rregulluar, nuk kishte çfarë të rregullonte.



Alegoria e Dibrës

MEVLUD BUCI

Alegori, anekdota, shprehje popullore

Botimet M&B
ISBN: 978-9928-172-34-1
Faqe: 268
Çmimi: 1500 lekë



Një pasanik që kishte shumë bagëti merr plakun e zgjuar Ramadan Cani nga Dardha dhe shkonjë te Murat Kaloshi. Murati, për të respektuar pasanikun, i liron kryet e vendit, ndërsa Ramadani ulet në fund të odës. Murati nis kuvendin me pasanikun, mirëpo ky, ngaqë nuk dinte muhabet tjetër, foli vetëm për punë bagëtishë. Murati mërztet tepër, prandaj, për të ndërruar bisedë, i drejtohet Ramadanit:

– Fol, o Ramadan, edhe ti njëherë!
– Nuk kam ç’me folë, – tha Ramadani, – se ka hy fati në tru të gomarit.

Agai i nëntë maleve të Dibrës, Salë Demiri shkon në një dasëm ku nuk e njihje njeri. Meqë ishte i veshur keq, askush nuk i liron vendin dhe e vënë më ngrënë në sofër të fundit. Të nesërmen Sala shkon e vesh dollamën e kuqe dhe kthehet përsëri në dasëm. Sa hynë brenda, menjëherë i lirojnë kryet e vendit dhe e vënë në sofër të parë. Kur fillojnë me ngrënë bukë, Sala ngre cepin e dollamës dhe, si e vu mbi sofër, thotë: “Ha dollamë e pi dollamë, se jam ai që kam qenë mbramë”.

Zenel Doda nga Reçi shkon te një bashkëfshatar dhe i thotë:

– A do më ndihmosh nesër me prashit arën?
– Nuk mundem se kam shumë punë, – ia ktheu fshatari.

– Po vitin tjetër, a do të më ndihmosh?
– Patjetër, do të ndihmoj, – ia ktheu fshatari.

Vitin tjetër Zeneli i shkon përsëri fshatarit dhe i kujton premtimin që kishte dhënë një vit më përpara. Fshatari, i zënë ngushtë, nuk e zgjati fare llafin, por menjëherë merr shatin dhe niset në drejtim të arës së Zenelit.

Osman Nezhën nga Gur–Lura, e pyetën njëherë dibranë:

– Përse paria e Dibrës pas vitit 1920 nuk mund t’u bënte ballë fuqive serbe?

– Parisë së Dibrës i ka ngjarë si puna e atij gjarpërit me dy kokë, që u dogj në zjarr; njëra kokë tërhiqej në një anë, ndërsa koka tjetër tërhiqej në anën tjetër, – ua ktheu Osmani.

Në një kuvend burrash ku ishin dibranë e lumjanë bisedohej se kush ka luftuar më shumë për atdhe, Dibra apo Luma. Pas një debati të gjatë, e lanë ta ndante plakun i zgjuar Mane Kacani. Manja, si u mendua, tha:

– Dibra e Luma janë si rana e horosani, që, kur bëhen bashkë, s’ka ç’u bën mbreti as krajli.

Në një kuvend burrash në Mat, një matjan, për ta ngacmuar Brahim Kacin nga Lura, i thotë:

– Si shpjegohet që Lura herë shkon me Mirditën e herë shkon me Dibrën?

– Lura është si puna e atij kaut të mirë, që ia kanë nevojën të dy palët, ngaqë lëron në të dy krahët, – ia ktheu Brahimi.

Ashtu siç është një pijanec i dhënë pas rakisë, Selim Sula kishte qejf kafën. Edhe kur udhëtonte, Selimi mbante me vete kutinë e kafes, xhevzen dhe filxhanin. Ndalej në anë të rrugës, ndizte zjarrin, bënte kafën sade, e pinte, mblidhte takëmet dhe ngrihej e vazhdonte rrugën.

Atje ku shkonte mik, në qoftë se kafje i dukej e hollë, nxirrte kutinë nga xhepi dhe i shtonte filxhanit edhe një lugë kafe nga e vetja. Këtë e kishin mësuar të gjithë në Dibër e nuk ia merrnin për keq.

Njëri priti Selimin në shtëpi dhe për t’i plotësuar dëshirën qejfliut të kafes, i bëri kafe aq të trashë, sa ngjante sikur të ishte kos. Selimi, sa ngriti filxhanin, u mundua të thithë, por më kot. Atëherë iu drejtua të zotit të shtëpisë:

– Or mik, faleminderit, por kafja pihet, mik, nuk hahet!

Xhaferi e futi djalin e madh në thes, e vuri në shpinë dhe përfundimisht vendosi ta mbyste në Dri. Sa u afrua pranë urës prej kah do ta hidhte, takoi një luznak që po vinte në Peshkopi.

– Njatjeta, o Xhafer! – e përshëndeti luznaku, – qenke lodhur shumë... Po ç’ke ngarkuar n’at thes, bre burrë?

– Lëre, lëre – ia ktheu tjetri shumë i zemëruar, – se jam nisur për të mbytur djalin në Dri.

– Mos bre burrë – ia ktheu luznaku me habi, – a ke luajtur mendsh?!

– Po, po, do ta mbys dembelin – i tha Xhaferi me vendosmëri.

– Bjerma mua në shtëpi, pashë Zotin se me arra do ta ushqej e në Dri djalin mos e mbyt, se do të të shajë gjithë Dibra.

– Babë, – doli një zë nga thesi, – pyete këtë xhaxhin, arrat a të qëruara i ka?

Luznaku, mbeti si i shastisur, kurse Xhaferi i tha:

– A e dëgjove, or mik, se dhe arrat i don të qëruara? Ky është djali im!

– Mos u mërzt, o Xhafer! Këtë e paske haram, por Zoti do të të bëjë hallall të voglin.

– Çfarë?! Çfarë?! – ia ktheu në moment Xhaferi. Ky i don të qëruara, kurse ai i don vetëm të shtypura.

– Atëherë, meqë qenka puna kështu, o Xhafer, dëgjo një këshillë – i tha luznaku: – Merre djalin për dore e çoje në shtëpi e merre gruan për dore e bini n’Dri.

Vite më parë, në qytetin e Peshkopisë endeshin rrugëve Ali Dypjaka e Sherif Abazi nga Shumbati i Dibrës.

Ata të dy, nga varfëria kishin braktisur fshatin dhe jetonin me lëmoshë në qytetin e vogël. Jo vetëm nga ekonomia, por supozohej se edhe mendërisht nuk ishin në rregull. Edhe kjo ishte një arsye që ata u larguan nga fshati ku kishin lindur. Qytetarët hanin me ta, por edhe i ndihmonin.

Pas ca kohësh, nga mënyra e keqe e jetesës, Sherifi

u sëmur dhe, në momentin më të vështirë të jetës së tij, trokiti në fshatin ku kishte lindur. Fshatarët e ndihmuan pa kursim, por nga sëmundja e rëndë, Sherifi ndërroi jetë.

Ditën që vdiq Sherifi, për rastësi, Aliu ndodhej në Dypjakë, ku kishte shkuar si gjithmonë, për t’u çmallur me fshatin e vet.

Aliu, ditën që kishte vdekur Sherifi, ishte zgjuar dhe rrinte si i shastisur në mesin e fshatit. Kaloi andej një fshatar për në punë dhe, pasi përshëndeti Aliun, si për ta ngacmuar, i tha:

– A din gjë, or Ali, ç’ka ndodhur sot?

– Jo, – i tha Aliu.

– Si jo? – i tha fshatari. – Sot varroset në Shumbat Sherif Abazi.

– Si more paska vdekë Sherif Abazi! – klithi Ali Dypjaka. M’qenka ba borxh me ra e me pi një kafe n’Shumbat, eu bre!

Aliu zuri vend. I çuan cigaren e kafën pa vonesë dhe konaku priste me padurim ngushëllimin e Aliut.

– Na paska lënë Sherifi, o burra! – foli ai.

– Na la, o Ali, na la – u përgjigjën pjesa më e madhe e konakut.

– E po pra, or burra, asht t’u m’ardh shumë keq, se sot hyn n’dhë burri ma i mirë i këtij katundi.

– E n’çfarë partie bën pjesë ti, o Zabit? – e pyetën fshatarët e tij Zabitin, pas tranzicionit, në një dasmë.

– Për nder, – tha Zabit – kam mbet pa parti.

– Si ore, paske mbetur pa parti, që janë me aq bollëk? – i tha njëri nga të pranishmit.

– E dini si e ka pësuar Zabit, o burra, – tha hoxha i katundit që ishte ulur në krye të vendit. Njëherë moti njëri kishte vendosur me e prish zabelin e me e ba tokë buke.

Një ditë para, në mbrëmje, i zoti e thirri hoxhën, shkuan në zabel dhe, me një dua, u bëri thirrje gjallesave të ikin që të mos digjeshin, sepse do t’i vinin zjarrin zabelit. Nesër, në mëngjes, i vunë zjarrin zabelit. Mbasi u dogj zabeli, u nisën për ta punuar tokën, për ta kthyer në arë. Zabelit akoma i dilte tym, kurse në majën e një lisi, fishkëllente një gjarpër që rrezikohej nga flaka. Punëtorët u habitën kur e panë, kur i zoti i zabelit, i tha:

– Po ç’pate, more gjarpër, që paske mbet këtu? Ne të lajmëruam që të largohesh.

– Po, po, – tha gjarpri, – por unë, siç e shikoni, kam dy kokë. Njëra më thoshte shko tërma e tjetra shko tëposhtë. Unë nuk dija çfarë të bëja dhe mbeta këtu në vend.

Një bari kishte rënë në hall të madh, sepse, kur nxirrte bagëtinë në kullotë, një ujk i hante nga dytri dele. Bariu disa herë e kishte qëlluar me pushkë, por plumbat nuk e zinin egërsirën. Atëherë, për të shpëtuar, bariu i tha ujku:

– O ujk, po vazhdove çdo ditë të më hash delet, së shpejti do të ma zhdukësh tufën, prandaj që të shpëtosh nga plumbi e unë të shpëtoj delet, a biem në ujdi?


– Fol! – i tha ujku.

– Unë çdo ditë do të të jap nga një dele ta hash, ndërsa ti do të më ruash bagëtinë nga egërsirat.

Ujku pranoi. Kështu bariu i jepte delen, ndërsa ujku ruante tufën. Pas disa vitesh, kur ujku nisën t’i zbardhen qimet, ia hëngri fjalën bariut. Një mëngjes, kur bariu shkoi të nxirrte bagëtinë në kullotë, pa gjysmën e tyre të shqyera nga ujku.

– Çfarë ke bërë, o ujk i pabesë? – i tha bariu, – a nuk të mjaftonte delja që të jepja çdo ditë?!

– Delja më mjaftonte, – ia ktheu ujku, – por kisha frikë se mos harroj zakonin e babës.



TREGIM NGA
AHMET KAMBERI

Shejf e shkruiej!

Një herë, një plak nga Peladhia, ishte ulur buzë xhadesë ku kalonin njerëz e karroca dhe po vështronte n'qef të vet. Kalon andej një kaloshinë e madhe e zezë dhe zbret dikush. Kalon rrugën dhe i afrohet plakut.

-Përsëndetje, zotëri!

-Shnet (shëndet) e t'mejra (të mira) paç, or lum zotneja, ia ktheu plaku.

-A mund t'ju pyes se ç'po bëni këtu, ndenjor në këtë buzë rruge? - pyeti i ardhuri.

-Po punoj, zotnej?

-Po çfarë pune bëhet duke ndenjor, mor mik? - pyeti përsëri i sapozbrituri nga kaloshina e zezë, i kureshtuar nga kjo përgjigje.

-Po sodis e po menoj, se kazmës s'ia kam takatin e as më hyn ma në punë.

-Po më bën të ulem, or mik, - tha i porsazbrituri nga kaloshina e zezë, duke e vështruar plakun me habi.

-Si të duesh, zotnej. Po s'tu nënë pantullt (ndyen,ndotën pantallonat), mun (mund) të uleni e ta bojn një dorë muhabet.

Zotnia i sapozbritur nga kaloshina e zezë, nuk e zgjati, po nxori një shami të bardhë nga xhepi, e shtroi përtokë dhe u ul pranë plakut. Nxori nga xhepi një paketë me cigare dhe ia shtriu atij.

-Falemnerit, po unë kam hjek dorë nga duhani. Iu ankova një doktorri, se kishnje pak kollë që m'a pat mërzit shpirtin. Ai më vizitoi, si në vakt, dhe më tha: “A do ta zgjasësh pak jetën, zotni?”. “Due, - ia ktheva unë, si s'dashkam, se nuk thkehem ma këtu, po kjo s'asht punë qi varet prej meje”. “Varet, varet, - më tha ai, - se tensionin e paske normal, zemrën jo keq, damarët nuk më duken kaq të moshuar. Paske një bronkit të vjetër, - më tha ai, por është punë që rregullohet”. Pastaj më pëti (pyeti) prapë: “Duhani e pini?”. Po, e pej, - i thashë, sall nja 20 cigare në ditë”. “Po alkool, pini”. Unë, thartova pak turijt, ene i thashë: -“E pej pak atë të shkretën”. “Po çështë kjo “e shkretë”, o burrë. Pi apo nuk e pi alkool, më thuaj”, - ma ktheu pak si me bezdi, ai. “E pej, mor zoti doktorr e pej rakejn, - i thashë dhe nuk e zgjata për t'i tregue se pse i themi “e

shkretë” na asaj. Desha t'i kallëzonja historinë si i ka met “e shkretë” rakejsë, se si vajtonin me morekujeee, Hasufllarët nga Valkardha, kur kumllat s'bojshin lule, e si e dejnë (dehën) keçin e komshijes, - e shkreta, ishte një grue e mejr prej knej, qi Zotii ndrejtëshpirtin aqe ku a(që) Zoti i ndrittë shpirtin atje ku është).Ajo e shkreta shkoi t'u kërkonte ndihmë se keçi i saj i vetëm kishte marrë jerm. Po Hasufllarët, ulur rreth kazanit tue zie rakejnë, e ia kishin shem (shembur) n'rakej keçin, ithanë se: “Ma mejr t'a therte e t'ua vinte atyne për meze, se sa t'i cofte e t'i shkante dam.” Ne ajo e ngrata ashtu bani. Po t'i pëtnje Hasufllarët, kshtu si po m'pët mue, ata do të përgjigjeshin: “Po e pejmë na atë të shkretën”. Se ata e kan qit kët fjalë dhe na ka met (mbetur).Por doktorri s'kishte nge për historitë e meja (e mia) dhe unë e mëlla (mbylla) shkurt, tue i thanë se kshtu i themi na rakejsë. “Mirë, atëherë, - më tha doktorri -, kur unë them se e ke në dorë vetë të rrosh më gjatë e më mirë, e them se pashë që i ke këto mundësi. Problemi është se ti pike duhan dhe, po e pike mirë edhe atë “të shkretën”, siç e quan zotrote. Unë them, duhani është si gjarpri në gji, sado mik të vjetër ta kesh. Atëherë kur ti s'e pret, ai do ta bëjë punën e vet. Ajo e “shkreta”, vërtetë nuk është si gjarpri, kur je i zoti të pishë vetëm një teke a dy në ditë dhe të mos i bësh tri, katër a pesë.Por po e teprove, njësoj të bën keq edhe ajo. Tani, si të duash. Unë them se po hoqe dorë prej këtyre armiqve “të dashur” që më paske, do t'i grisësh edhe disa palë këpucë”, - ma preu ai. “Unë, u menova e u fiqirova, - vijoi plaku -, ene i dhashë karar ta ngjoj atë doktorrin. S'kam qef të t'hiqem (tërhiqem) rrëshqanas për aq sa më ka met (mbetur). Po ma mejr e lajmë kët muhabet, se kam frëkë (frikë) se ju mërzita”.

-Jo, jo, aspak, ia ktheu zotnia i zbritur nga kaloshina e zezë, i cili u kureshtua edhe më shumë nga kjo bisedë e rastësishme. -Them se mund të më hyjnë edhe mua në punë këshillat e atij doktorit tënd, po më thuaj çfarë po sodisje këtu”.

-Aaa! - ia bëri plaku, - s'di a ke durim të më ngjojsh zotrrote?

-Me kënaqësi, madje, - tha i zbrituri nga kaloshina e zezë.

-Mejr, atëhere. Kam gjelm (djem) e cuca, ene qerët (të tjerët) kanë, kam ara, lvadhe e zabele, ujë për lezet e bereqet, por hajrin s'po ua shof. Kto gjelmt e cucat nuk po ma mushin menen (mendjen). N'shkollë kanë shkue e gja nuk dinë. Se ç'u kanë msue ca msime për ibret. Nji herë iu thane “Prejshini, mor, kto vjetërsejna, prejsheni mor e qitjani themelet ktij veni qi e kanë nërtue komunistat për ibret, për qefin e vet. Ç'keni ju! pare u apim na sa të doni, ta bani krejt të rej. Bukë? Ç'asht ajo, more. Si të keshë pare, buka

vjen nga anë e anës, bile e gietume (gatuar). Rrejni (rrini) ore, mos u rropatni kot me kto vjetërsejna. Mas nesh, bre! dhe keni për të pa se ç'asht ekonomia e tregut qi po u themi na”. Ene më t'i ranë, hajt bre! Prejsh e prejsh e s'kishte t'marueme e shkreta! Kanë met ene disa gjana pa prejsh, po janë t'rana, e hala s'ua ka marrë menja. Kush e di si do t'ua gjejnë ene atyne. Ja ke i prejshën, po paret, si i bahet për paret? Aha! - u thanë -, paret fitojini vetë. Ene vërte i kanë fitue do pare disa. Se si, ata e dinë. Ene kanë ba disa punë për hesap të vet. Ene i shof të gëzuem, mor, këta të rejtë. Pallë areiu (ariu), themi na ktej nga Peladheja. Punën e kanë për turp, gjith ditën tu pej çmos. Qefi, qef! Se kha i fitojnë paret, ata e dinë. Po bahen trejdhejt e kusur vjet, mor burr i dheut, dhe nuk po ia shohim hajrin ksaj ekonomisë së tregut. Disa po, po na sherrin po i shofim. Mejr mor burri i dheut, po njani thumit e tjetri patkoit, pa prâ e pa prâ. Se di se si mun të bahet përpara kshtu. Uku ma i madh uluret: “Kapnja ukun mor se ua faroi (çfarosi)bagtinë! Po ç'u ka lanë ai qerve për t'maru, mor zotnej i mejr? Megjithata, pasunia e ktij veni s'paska t'marue! Hajde nji uk i madh e ha sa t'mune. Përze atë e hajde nji qetër, ibret ne ai. Hajt se po ia bojn kabull ukut të madh, po na mëtën (mbytën) uqt (ujqërit) e vegjël, mor burrë! Çakajt e dhelpnat s'po na lanë as thërmejat (thërrimet)! Ne ju m'thoni: Çfarë sodis e pse menoj? Po, sodis mor zotnej i mejr, ne menoj e menoj se them: me padije nejtëm nja 500 vjet nën Turqi. Murëm pak dritë e dituni dhe e përparuem pak nga pak vendin. Po teshtej (tashti)! teshtej, të shkolluem me demek po me padije, si do t'i bahet? Derrat, or zotnej i mejr, po t'i lajsh pa har (hangër), nejsin e hanë njani-qetrin. Po njerëzit kanë qetër të harme, se kanë men (mend)(!). Ene disa dinë të hanë fort mejr, bre burrë! Disa gjeshejsen (rregullohen) mejr se u gjiten (ngjiten) atëne (atyre) si (që) dinë të hanë. Qerët (të tjerët) e dinë vetë se si ia bojnë hallit. Po nesër mor zotnej, nesër ç'dë (ç'do) bahet, se t'flejsh përmej flerej (përmbi flori), e t'rropatesh për kafshatën e bukës, kjo asht për t'lanë menen e kresë. Ja, or zotnej i mejr, ka hala disa si puna ime, që si le menja rahat. Po mue m'thonë: “Rrej (rri)or plak e mshile (mbylle). Mshile mor at bilbile! Ç't'u desh të (ty) të luftoje me italianë e gjermanë! Po t'i kishe lanë rahat tej me skotën tane (tande), ata do t'na kishin qytetnue, e nuk do ishim ba kshtu si na bate ju. Mshile mor at bilbile, se na ban me nerva kur t'ngojm të tue prashejt kshtu! Mshile mor, e na le rahat, se s'ka njeri veshë me ngju prrallat tua!”. Mejr, unë po e mshel, mor lum zotneja, po nga do të merret vesh e vërteta? Prej atyne qi u banë nji me ata qi na luftuem? Apo nga ata qi na sabotuen? Hajt e jepi dum ksaj pune! Po t'i lajmë ma mejr këto muhabete,

(Shih e shkruaj!)

se kushdi, t'çava krët (kokën) ne të(edhe ty)! Po tej, kha kshtu or zotnej?

-Ja! Kënde, për të parë, u përgjigj zotnia i kaloshinës së zezë dhe vazhdoi më tej: E di zotrote! – tha zotnia i kaloshinës së zezë duke picërruar sytë, -të dëgjova me vëmendje dhe do të doja t'ju pyesja: Si ju duket juve kjo qeverisja e tanishme?”

-Hëm! Ia bëri peladhejasi duke ofsha, -folat gjatë e po i bie shkurt, qi t'mos ju lodh ma shumë, zotnej: Shejfe shkruet!Shejfe shkruet! - e i hodhi një vështrim të ngultë, zotërisë së kaloshinës së zezë. Ky, sikur u pezmatua pak dhe ia ktheu:

-Mirë o burrë, po çdo me thënë kjo “shef e shkruj”.

- Shejfe shkruet, kshtu themi na ksaj ane, kur punët duken sheshit dhe duem (duam) të mos hallakatemi shumë.

-Mirë mo, mirë, e dëgjova unë atë “shef e shkruj” tënd, por nuk po marr vesh gjë me këtë. Ç'lidhje ka kjo me atë që unë ju pyeta, tha i mërzhitur zotnia i kaloshinës së zezë. Plaku, e pa një herë drejt në sy atë dhe i tha:

-Mejr, atëhere, po ta t'holloj pak, e po t'kallzoj një prallë qi ma kallëzonte Babgjishi im, kur isha i vocërr, -dhe vazhdoi, -nuk mërzhitet zotneja juj, besoj!

-Jo, Jo! - ia ktheu zotnia i kaloshinës së zezë. Po ju dëgjoj. Plaku u mbush me frymë, hodhi vështrimin nga mali përballë, i Zderqanit (Zerqanit) dhe ia nisi:

-Një herë, një mreti na i ishte mush menja me pët njerëzinë se si ishte për to mretneja e tej (tij). Lajkaxhi kishte sa të duesh! Të tjerë bojshin sikur s'mershin vesh. Të tjerë prashejtnin (prashitnin, ia këpusnin) rroma për toma. Në fund të mezhlizit rrejte një plak i karrakejt (i mbaruar).

-Po tej! Si thue tej, mor plak?

-E ç'ransi ka fjala ime Naltmadhnej, unë e kam har (hanger) tagjinë, i tha plaku, masi (pasi) shoi cigaren me gjethe të thata pjergulle, qi e pinte në vend të duhanit. “Peshë ka fjala e atyne q' t'lanë e t'lyen”, - e mëlli (mbylli) ai. “Fol, mor fol! i tha mreti, me inat,- Pa të dëgjojmë edhe ty”. Mejr, Naltmadhnej, po unë jam i paditun, e i bie shkurt punës”. “Mejr mor mejr, bjeri si të duesh, po fol!”, - i tha mreti. “Shejfe shkruet, Naltmadhnej, shejfe shkruet”. “E, çdo me thanë tej me kta (këtë), mor matuf! -bërtejti (bërtiti) mreti”, - ene urdhnoi rojen e vet ta shtronte në hu të shkretin plak. Po, plaku ia ktheu: “Prejt Naltmadhnej se s'asht noi trejmnej (trimëri) e madhe të shemish (shembish) në hu një t'maruem. Ta marrim pak ma shtrue, e shte (qe, ja) ku po ta kulloj”. Ene filloi plak tu e kullue.

-A e shef Naltmadhnej qat majë qaqqe (atje), ku nrejt (ndrit) një llojë e zbetë (llampë) qi nizet e shuhet sikur i frë (fryn) era. “Po! e shof”, - tha mreti.

-Shejfe pak ma teposhtë, ç'vjen mas llojë, a shef noi dru të drejtë n'at pëllë (pyll)? “Jo!” - tha mreti, -të gjithë të shtremët. Njani ma shtrem se qetri (tjetri)”.

-Po, qetër, tha plaku, nuk shef qetër gja? “Po!, tha mreti, shof uq (ujq) e dhelpna plot”.

-Heu bre, ia prejti plaku. A plot a?! “Plot, plot! tha mreti”.

-Po pula, dhen, dhej, lopë, a shef nakun? - pëti prap plaku. “Jo! tha mreti. Nuk po shof kurrkun”.

-Po gjelm e cuca të ra (reja), a shejfnj tu punue në ara, lvadhe a nakun qetër? “Jo! - tha mreti, -kurrkun”.

-Po në mejhane, kafehane, vallëzimhane, a shejfnj gja? “Po! - tha mreti, plot e përplot me gjelm e cuca. Hm! ia bani ai, tue tun krët (kokën), ktâ (këtë) s'kishte për t'ma marrë menja kurrë”.

-Ja! kësaj i thonë “shejfe e shkruet”, Naltmadhnej. “Shejfe, shejfe! ia bani mreti. E si na thane tej se nrege këto punë, mor garroq (plak i thatë me një këmbë në varr)”?

-Megenë se po m'pët Naltmadhnej, unë them se drunat e shtremët që nakatosin pëllin e i zajnë dritën gjithkuj e gjithçkaje, prejten (priten); uqt, dhelpnat e çakallat përzejhen e u prejten rrugët qi t'theken. Po kjo punë s'bahet po nuk gjetët ca barej (barij) të mençëm, të zott e të drejtë. Ene, masnaj, keni për të pa, Naltmadhnej, si merr dritë pëlli, si shtohen dhentë, dhejtë, lopët e pulat, si mushen arat e lvadhet me gjelm e cuca tue punue, si meten gati shkretë mejhanet, kafehanet e vallzimhanet, si marrin punët për mejr.

-Kshtu tha plaku ne e msheli giojën. Mreti, e pa njëherë menueshëm, tuni krët, ua bani me shenjë rojave, i kërceu atit të bardhë dhe mur (mori) rrugën kha (nga) kishte ardhë, megjith shpurë.”

-Ja! kjo ishte përralla or zotnej i mejr. E m'duket se ta kullova atë “shejfe e shkruet-n”. Po, bamë gjith këtë muhabet e s'i dham të njoft njani-qetrit, bre burrë! Unë për vete jam qiki (ky) plak qi ngrys ditët e veta këtu në Peladhej, po s'e le menja rahat të ngratin. Po tej, or zotnej i mejr, kush na qenke?

-Unë, - tha zotnia i kaloshinës së zezë, - unë jam i pari i qeverisë dhe dola një herë kënde për të parë se ç'bëhet, e ç'mendohet.

-E po! qofsh shnosh e mejr, zotnej, e t'paçim me men, si t'parin tonë si (që) t'paskemi, e rruga t'u bafitë dritë po e zgjodhe mejr!

I pari i qeverisë, u ngrit, shkundi me nervozizëm shaminë e bardhë që pat shtruar për t'u ulur mbi të, për të mos ndotur pantallonat, e palosi, e futi në xhep atë dhe i dha dorën plakut, duke i thënë: “Mbeç me shëndet, zotëri!” Hypi në kaloshinën e zezë, i tha djalit që drejtonte kaloshinën “Ktheu mbrapsht!” e iu lëshua udhës andej nga kishte ardhur.

Çarku

TREGIM nga Artan Gj. Hasani

(Vijon nga faqja 1)

Zogu akoma përpëlitej në çark, ndërsa unë, më keq se zogu, përpëlitsha në çarkun e kureshtjes sime. Ndërsa fqinji u drejtua për nga vendi ku ndodhej çarku, unë shfrytëzova rastin të lexoja fletën e bllokut. Ajo që lexova, më tronditi. Vendin e kureshtjes si me magji e zuri një marramendje që pothuajse më la pa frymë. Kuptova se çfarë ndodhte brenda atij apartamenti që tashme më ngjasonte si një kafaz që mbante kyçur një njeri dhe një zog. Në bllok ishte një evidencë e plotë, një statistikë për t'u pasur zili e tërë lëshimeve nga kafazi dhe kapjeve në çark të kryearzës së shkretë gjatë çdo dite. Ishte shënuar saktësisht koha e lirisë së saj që nga dalja nga kafazi e deri në çastin e zënies në çark. Një ritual që ndodhte gjatë gjithë ditës deri në mbrëmje vonë, siç tregonin edhe orët e shënuara mbi fletët e zverdhura të bllokut. Matje statistikore e lirisë së zogut. Nuk ishte diçka që kishte të bënte me kulturën e rritjes së zogjve... Ishte diçka përtej zogjve dhe njerëzve... ose diçka mes tyre... që nuk i përkiste as njerit e as tjetrit...

Zhurma metalike e portës së kafazit më ndërpreu leximin. Kryearza ndodhej përsëri brenda kafazit në pritje të lridaljes së radhës. Ai qëndronte me duart në xhepa... I përqendruar me sytë mbi zogun. Pas pak euforia që të jep pushteti mbi lirinë e tjetrit ish larguar prej tij, për t'ia lënë vendin një dridhjeje... më pas një ngashërimi... e më pas lotët rrodhën mbi rrudhat e asaj fytyre të murosur që tashmë dukej se kishte harruar për praninë time në atë dhomë. Kisha mbetur i palëvizur herë duke vështruar atë e herë zogun e shkretë që fillimisht lëshoi ca cicërima... e më pas veç shihte ngultazi herë mua e herë padronin e tij. Më kishte bërë përshtypje që kryearza nuk kishte cicëruar as gjatë fluturimit e as kur ish kapur në çark, por vetëm pasi ishte gjendur brenda në kafaz.

Sot ai vdiq.

Mes pislëkut... glasave... kafazëve të braktisur me dyer të shqyera një mjek konstatoi shkaku e vdekjes. Komë alkoolike me pasojë vdekjen. Më pas nën urdhrat e një polici bashkiak dyjvegj morën kufomën e mbështjellë me qilimin e lerosur dhe e transportuan drejt një makine të vjetër varrimi.


Ishin larguar të gjithë pa e vënë re kryearzën e tulatur brenda kafazit.

Ndërsa po thithja i përhumbur cigaren një cicërimë e zgjatur më kishte përmendur. Futa dorën brenda kafazit dhe mora në dorë zogun e tulatur që dridhej sikur të kishte kuptuar vdekjen e të zotit... Pasi e pashë për të fundit herë atë krijesë të vockël që më lidhte me fqinjin e humbur, hapa pëllëmbën e dorës dhe me një të shtyrë të krahut e nisa lart në fluturim...

Kryearza bëri një xhiro rreth meje që po e shikoja i mrekulluar në mes të oborrit dhe u nis në fluturim drejt qiejve... Një rrotullim mbi ndërtesat përreth... edhe një tjetër... edhe një tjetër... u fut mes një tufe zogjsh... fluturoi bashkë me ta në pikiata dhe pirueta mahnitëse... pastaj u shpëput nga ajo skuadrilje zogjsh të lirë... fluturoi përsëri e vetme drejt qiellit. Papritur krahët iu këputën dhe pas një çasti u përplas pa jetë përdhe...

(Marrë nga libri “Rutina perfekte, Botimet B&B, Tiranë 2019. Çmimi: 700 lekë)

Për poezinë e Avni Ndreut



Gjurmë në fjalë

AVNI NDREU

Poezi

Botimet M&B
ISBN: 978-9928-353-89-4

Faqe: 144
Çmimi: 500 lekë



Nga Halil RAMA

Opinion i gjerë publik e ka njohur dhe e njeh më shumë si artist, si kërcimtarin e koreografin më të mirë të qindra valleve me motive nga të gjitha trevat e Shqipëisë e të arbëreshëve të Italisë. E njeh si ndër themeluesit e udhëheqësin artistik të të parit edicion të “Odës dibrane” dhe po ashtu si themeluesin dhe drejtuesin e Ansambllit Artistik “Hazis Ndreu”- Nderi i Kombit, ansambël ky që në 10 vitet e fundit ka fituar dhjetra çmime të para e trofe në festivale kombëtare e ndërkombëtare, si në Turqi, Ulqin, Shkup, Strugë, Kërçovë.... Ai është vlerësuar me titujt “Qytetar Nderi” i Peshkopisë, “Nderi i kulturës dibrane”, “Ambasador i paqes”, është dekoruar nga Presidenti i Republikës me titullin e lartë “Mjeshtër i Madh”. Ky është Avni Hazis Ndreu....

Më 11 nëntor 2022, Avni Ndreu u promovua edhe si poet i shumëtalentuar. Për poezinë e tij foli elita krijuese dibrane.

NJË “ODË POETIKE” BRENDA SHTËPISË SË BABAIT

Prof. Dr. Gafur Muka, redaktor i librit “Gjurmë në fjalë”, padyshim që do të prezantonte në këtë event analizën më profesionale e kualitative. Sepse në gjykimin e tij, të shkruash poezi duhet të krijosh ato nëpërmjet proceseve: ndjej, mendoj, mbushem, guxoj dhe ...shkruaj. Duke arsyetuar kështu, ai shpreh bindjen se: “Avniu e ka ndërjerë poezinë që në fëmijërinë e tij, madje edhe menduar e recituar atë. Ai e ka dëgjuar fjalën poezi në një formë që pak veta kanë fatin ta dëgjojnë: kur donte të luante si kalama, kur i vinte për të qarë apo për të qeshur po si kalama atij i është thënë: pusho mor voc, lerë babën rehat se po shkruan! Dhe ai që po shkruante ishte Hazis Ndreu. Dhe Hazis Ndreu ka shkruajtur edhe poezi. Dhe Avni Ndreu i ka lexuar herët poezitë e tij. Ai i ka lexuar me zë e pa zë, i ka mësuar përmendësh, ua ka recituar edhe shokëve, kur ata ja kanë kërkuar një gjë të tillë. Dhe kështu, Avniu e gjeti poezinë qysh kur ka qenë kalama. Por ai e ka gjetur poezinë ashtu siç e shkruante Hazis Ndreu. Poeti ynë i sotëm ka dëgjuar t’ja vlersojnë poezinë e të atit shoqëria e tij, pastaj lexuesit e shumë të poezisë së H. Ndreut deri dhe Dritëro Agolli. Në këtë klimë, Avniu ka filluar të krijojë vargje e strofa, të cilat gjithësi nuk ishin si ato të babait. Ndaj, ai edhe kur i shkruante i griste dhe përpiquej t’i harronte”.

Për redaktorin Muka, në vëllimin “Gjurmë në fjalë” që hapet me poezinë “Elegji” kushtuar Hazis Ndreut, duket që vargjet janë shkruar me veneration për gjithë veprën poliedrike të babait, nga i cili ai trashëgon fantazinë krijuese, ritmin marramendës dhe shpirtin poetik. Ndaj dhe prof.G.Muka vlerëson që krijimtaria poetike e Avniut është në rrjedhën e të atit, duke krijuar nëpërmjet saj një “odë poetike” brenda shtëpisë së babait.

“Duke e lexuar vëllimin poetik ‘Gjurmë në fjalë’ konstaton që tematika e tij është fort e larmishme. Të duket se je futur në një bahçe me mollë dibre, ku jo vetëm pemët por edhe kokrat janë të ndryshme edhe në formë edhe në shije. Aty gjen patriotizmin, profesionin, politikën, dashurinë, idhnimin, pëlqimin, ironinë, llafin nën mutaf etj”, tha ndër të tjera gjatë fjalës së tij Prof.dr.Gafur Muka. Pasi e ka skanuar këtë libër, ai konkludon se “Poezia e Avniut është avniane (bio), është rationale dhe është e singertë. Poezia e Avniut nuk ka formatim tematik, nuk ka metrikë të ngurtë apo rimim standard e klasik. Ajo është poezi e ndjenjës spontane, e kualifikimit cilësor të ndjenjës, e konvergencës rationale poetike”. Po, prof.Muka ka të drejtë kur shprehet se “Edhe pse neve dibranëve kjo poezi na përthith si dibranë ajo është poezi përthithëse për të gjithë ata që shqiptojnë fjalën VENDLINDJE”.

ELEGJI

(Kushtuar babait tim Haziz Ndreu)

Shpirtin e derdhe ndër tela,
Këngën maleve ua fale.
Krahët ia more shqiponjës
E i bërë flatra në valle.
Zërin ta fali bilbili,
Ti forcë i dhe si Anteu.
Bjeshkëve jehonte kumbimi,
Heej! Po këndon Haziz Ndreu!
Vargun e fladite gurrave,
Aromë luleshqerre, aromë lulebore,
Shtruar në odat e burrave,
Në të sertat kulla malësore.
Në mijëra balada e ligjërime
Në histori bën zë Skënderbeu:
“Më ktheve në vendlindjen time,
Ti, biri im, HAZIZ NDREU!”

DIBRA IME

Jetoj me ty, Dibra ime,
Nga agimi në agim.
Në oda të moçme, në gëzime,
Me sy e mendje te Ti!
Me aromën e blirit zgjohem
Në të bukurën pranverë.
Me ty, Dibra ime, krenohem,
E mençur, e bukur... përherë.
Dielli i Korabit ballin ta ndrit

POEZI ME NUANCA LIRIKE

Si autor i këtyre radhëve ndjehem i vlerësuar nga organizatorët e këtij event, për faktin që në programin e tij kishin planifikuar që edhe unë të shprehja vlerësimin tim për nuancat lirike në poezinë e Avniut. Këto nuanca i ndeshim pothuajse në tërësinë e lëndës së këtij vëllimi me titullin sinjifikativ «Gjurmë në fjalë» . Ato na vijnë si : «aromë luleshqerre e aromë lulebore/, shtruar në odat e burrave/ në të sertat kulla malësore... » që në fillimin e librit, me elegjinë kushtuar Nderit të Kombit Hazis Ndreu – krenari dibrane dhe mbarëkombëtare, për vetë trashëgiminë letrare, kulturore, artistike e studimore, në shtratin e së cilës ecën mirëfilli, i biri Avniu – Mjeshtër i Madh. Ky poet tashmë i mirënjohur, pasi prej vitesh ka prezantuar krijimtarinë e tij në rrjetet sociale, e finalizon atë me këtë vëllim, ku në dhjetra poezi shfaq lirinë nëpërmjet përjetimeve të veta si: gëzimeve, dëshirave, shpresave, vuajtjeve dhe zhgënjimeve.

Kësisoj, nuancat lirike dallohen në poezinë «Ata sy/Ajo vetull harkuar/Si gjerdan/ Trup e shpirt zbukuruar ».. ku risi janë strofa me vargje dy e katër fjalëshe, poezi kjo e llojit dhe stilit të veçantë, mjaftë e pëlqyer dhe preferuar nga lexuesi.

Po në këtë linjë është edhe poezia «QESH », ku Avni Ndreu me nota lirike filozofon me të qeshurën, spse sipas tij :

« E qeshura/ Dhe diellit/ i jep/ shkëlqim../ Jetës/ Hare/ Gaz/ kuptim... ».

Por më të spikatura janë nuancat lirike në poezitë e identifikuar nga vetë autori, si të tilla, nga të cilat veçojmë ato me titull: “FUSHA E KORABIT», «STINA E DASMAVE», «VALËZ E JONIT», «LIQENI MAGJI », «DILEMË BUKURIE», «JU TË DY», «CUCË E DIBRËS»,etj.

Ndërkohë mund të konsiderojmë si perla poetike poezitë e Avni Ndreut të mbështetura në motivet popullore, si «NUSEHËNA», «CUCËMIRA», «SHEJTANKË», «ÇIKË E KOSOVËS», «BUZË E SY», «KUJT TI FALEM» etj.

Kësisoj, poezia e Avni Ndreut, e menduar lirisht dhe shkruar profesionalisht, paraqitet si një nga veçantitë në poezinë moderne shqipe.

Poezia e tij është prezantimi më i ndjeshëm i një mëvetësie estetike të rrafshit të epërm, është lodrimi me fjalën në tërësi, si figurë dhe si mendim, është një dremetje e ëmbël nëpër metafora, siç është kompozimi artistik i një jete të plotë njerëzore, të një jete me një përditshmëri mungesash që e trishtojnë dhe e bëjnë të vuajë poetin.

VARGUi Avni Ndreut është bio në çdo vjershë.../ Edhe kur na e ringjall të Madhin Hazis Ndreu.../ Edhe kur jeton me Dibrën nga agim në agim.../ VARGU i tij.../ I ëmbël.../ I butë.../ NJERËZOR...

Vargu i tij është bio.../ Edhe kur vargëzon aq bukur për dr.Benin.../ Edhe kur uron të bijën për ditëlindje.../ Edhe kur të dashurës i thotë: Ç’të kam bërë?!!!

Ja pra, pse është kaq madhështor ky poet i këngës... VARGU i tij të magjeps.../ Kur shkruan “PËR ATA SY”.../ Ashtu siç të mallëngjen/ tek “Poezitë e Drinit”...

Ai luan me valën.../ Dhe puth shtojzavalle.../ Kur shkruan për Rozafën.../Dhe Cucat e Dardhës....

VARGU i Avni Ndreut është bio.../ Edhe kur rebelohet...Për Mosmirënjohje”.....

Gjithë vezullime.
Valebardhë e Drinit
Gjithçka ta fladit
Moj Dibra ime!

ÇAST

Ulur
Mes shelgjesh
Buzë Drini.
Në vlagun
E pranverës
Ëndrrën
Ma merr vala.
Në lundrim
Mbi varkën
E shpresës.

MOSHË

Mbrëmja lodhshëm vjen
Përflakur në perëndim,
Me hallet e ditës ngarkuar,
Neonet ndez në vezullim.
Dhe një ditë nga ditët kaloj
Ashtu si shumë të tjera,
Ballit dhe një rrudhë ia shtoj,
Nuk jemi më si ngahera.
Shtriqemi në të butin kolltuk
Disi lodhjen ta largojmë,
Mosha luan si djalë kopuk,
Me vitet që mbi supe na rëndojnë.

VARGU i tij bio../ Na sjell aromën dehëse të blirit.../ Nga bulevardi i ëndrrave dhe shpresës...../ Dhe fladin.../ Nga Fush’ e Korabit.../ Herë me zë bilbili.../ Herë me magji kavalli...

Ja, pra: Ky është “poeti bio” AVNI HAZIS NDREU...

POETI QË TË DETYRON TË PUNOSH PËR LIBRIN ME PËRKUSHTIM, PASION DHE DASHURI

Një tjetër emër i mirënjohur në fushën e botimeve, Bujar Karoshi – themelues dhe drejtues i “M&B”, botuese e librave të më shumë se 300 autorëve të njohur, jo vetëm dibranë por nga e gjithë Shqipëria, pasi e falenderoi Aviun për besimin që pati për botimin e librit “Gjurmë në fjalë” e vlerësoi atë si njërin nga bashkëpunëtorët më të mirë në një proces botimi. Kjo sipas tij, për faktin se ky autor të jep besim dhe të vendos në një pozicion që të detyron të punosh për librin me përkushtim, pasion dhe dashuri.

“Ajo që dua të evidentoj te Avniu është këmbëngula e tij, puna e tij e madhe për të qenë dikush, për të qenë një emër në fushën e kulturës dhe traditës popullore. Dhe këtë e ka arritur, pasi me grupin e tij të valleve po përfaqëson Shqipërinë ne arenën ndërkombëtare.

Por Avniu, përmes punës, ka zgjidhur edhe një nga dilemat e mëdha që shpesh bëhej në odat dibrane: Se cila është më e vështirë, me qenë baba i mirë apo djalë i mirë.

Avniun, siç e thotë edhe në një nga vjershat e tij, e ka shoqëruar emri i mirë i babait gjatë gjithë jetës - dhe do vazhdojë ta shoqërojë sa të jetë gjallë, por vetë është bërë edhe më i mirë, sepse ka vazhduar traditën e babait, duke mos lënë të humbasë as emri dhe as puna e Hazisit.

Dhe kjo e dyta, pra puna, është një e mirë kombëtare, e cila do të bëjë që të mos harrohet edhe emri i Avni Ndreut”,- e mbylli fjalën e tij Bujar Karoshi.

Pas tij, aktori dhe regjisor i mirënjohur i dhjetra dokumentarëve televizivë në RTVSH, Llesh Nikolla – Mjeshtër i Madh, me interpretimin mjeshtëror të disa poezive të poetit Avni Ndreu, ngriti peshë dhe ngjalli emocione tek më shumë se 200 pjesëmarrësit në këtë promovim.

Në këtë event, si festë e poezisë avniane u mirëprit dhe u duatrokit fuqishëm edhe Liri Rasha gjatë interpretimit të këngës “Amaneti”. E identifikuar si zëbilbili i Dibrës dhe për talentin e saj të rrallë krijues, Liri Rasha, e dekoruar nga Presidenti i Republikës me titujt “Mjeshtër i Madh” dhe “Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut”, njihet edhe si bashkëpunëtoe e ngushtë e Avni Ndreut. Ndaj dhe mirëpritet e duatrokitet në veprimtari të tilla promovuese.

Ndërkohë, në këtë eveniment të ideoar dhe kombinuar edhe me elementë të show-u artistik nga moderatori i shumëtalentuar, ikona e gazetarisë sportive dhe dokumentarit televiziv, Defrim Methasani lanë mbresa me interpretimin e tyre virtuoz edhe këngëtarja Erida Stana dhe flautistja Livia Bushpepa.

Dhe s’kish se si të mbyllej ndryshe festa e poezisë avniane, veçse me performimin e një kolazhi vallesh nga artstët e Ansambllit Artistik që mban emrin e të Madhit Hazis Ndreu – Nderi i Kombit, që drejtohet nga i biri artist dhe poet Avni Ndreu – Mjeshtër i Mëadh dhe Presidenti i këtij Ansambli Muharrem Gjoka Mjeshtër i Madh dhe “Nderi i Qarkut”Dibër.

Setki Jashari – poeti i dashurisë



Nga Halil RAMA

Maqellara, djep i artit dhe kultures, apo siç njihet edhe si Myzeqeja e Dibrës, veç resurseve të shumta natyrore për ta konsideruar perlë turistike, shquhet në rang kombëtar edhe për resurset e shumta njerëzore e intelektuale.

Pikërisht, vendlindja e personalitetit të shquar Iljaz Pashë Dibra - Qoku, i cili më 10 qershor 1878 kryesoi mbledhjen e parë të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe që njihet për kontributin e tij madhor për çështjen kombëtare shqiptare, ndër shekuj, vite e dekada ka nxjerrë personalitete të shquara të fushave të ndryshme.

Njëri prej tyre është edhe poeti dhe prozatori Setki Qemal Jashari nga fshati Kovashicë i Maqellarës, i cili, pas dy romaneve të mirëpritur nga lexuesi e kritika letrare, “Emigranti fisnik” e “Meteori ndëshkues”, dhe librit me novela e tregime “A gjykohet dashuria”, vjen si befas në botën letrare edhe me vëllimin poetik “VEGIME DASHURIE”(Botim i “M&B”).

Këto katër libra u promovuan bujshëm në sallën e madhe të Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë, me pjesëmarrjen e dhjetra përfaqësuesve të elitës krijuese dibrane e të metropolit shqiptar, të cilët fillimisht ndoqën dhe vlerësuan dokumentarin “SETKI JASHARI – POETI DHE PROZATORI I DASHURISE DHE I DHIMBJES NJERËZORE” (me skenar dhe regji nga Halil Rama – Mjeshtër i Madh”), në të cilin spikaste interpretimi mjeshtëror i disa poezive të këtij autori nga ikona e kinematografisë Margarita Xhepa – Nderi i Kombit, si dhe profilizimi i autorit nga gazetari i mirënjohur Kamber Faruku dhe intelektual i Maqellara Demir Osmani.

Ish-Ministrja e Arsimit dhe Kulturës Tefta Cami, përveçse vlerësoi krijimtarinë e autorit u bëri të ditur pjesëmarrësve se edhe Jasharët e Prekazit të Heroit Legjendar Adem Jashari janë të një origjine me Jasharët e Kovashicës së Maqellarës.

Ndërkohë deputeti i Dibrës Lavdrim Krashi, pasi përgëzoi autorin S.Jashari të katër librave, shprehu mbështetjen e tij maksimale ndaj krijuesve letrarë dhe artistëve dibranë.

Më të larmishëm e bënë këtë veprimtari promovuese me interpretimet e disa këngëve, diva e këngës popullore e qytetare Dibrane Liri Rasha –Mjeshtër i Madh, dekoruar edhe me titullin “Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut”, këngëtarja Kristina Ndoja dhe këngëtarja Lirim Hoxha.

Fjalë zemre dhe vlerësime maksimale për krijimtarinë letrare të S.Jasharit shprehën edhe Prof.Aleksanda Pasko, Dr.Besnik Rama, poeti Përrparim Luca e këngëtarja Burbuqe Çuni.

Për krijimtarinë letrare produktive e cilësore, poeti dhe prozatori Setki Q.Jashari u vlerësua me Çertifikatë Mirënjohje nga Shoqata Atdhetare Kulturore “Bulqiza”, e cila ju dha autorit nga kryetari i kësaj shoqate Z.Bashkim Lami.

MOMENTET PSIKOMENTALE TË TRANZICIONIT SHQIPTAR NË PROZËN E SETKI Q. JASHARIT

Në tri dekada tranzicion të tejzgjatur, shqiptarët, ndoshta si asnjë komb tjetër, veç të tjerash përjetuan dhimbshëm, madje dhe tragjikisht plagët e rënda të emigracionit klandestin. Ky realitet i trishtë ka shërbyer si subjekt i dhjetra tregimeve, novelave e romaneve të autorëve, të njohur, por edhe të rinj.

Setki Q.Jashari, që bën pjesë tek këta të fundit, ka shkruar dhe botuar romanin “Emigranti fisnik”, ku në 266 faqe të tij trajton me mjeshtri artistike ngjarje dhe episode, produkte të kësaj plage të rëndë shoqërore. Prandaj dhe redaktori i romanit Prof.Kujtim Xhebexhiu shkruan në parathënien e tij se: “Në këtë vepër, gjithçka vjen e gjallë, reale, gati në natyrale dhe lexuesit i duket sikur i ka njohur me kohë personazhet e këtij romani, disa prej të cilëve, me shpirt mizor, i urren në kulm dhe ca të tjerë i simpatizojnë dhe i dashuron. Këta të fundit gdhenden në kujtesën e lexuesve, duke lënë mbresa të pashlyeshme. Patjetër kjo është meritë e autorit që arrin të skalisë figura të tilla mbresëlënëse ... ».

E tillë është krijimtaria e Setki Jasharit, si dhe e qindra shkrimtarëve të tjerë dibranë, të cilët, krenarë për origjinën dibrane të Heroit tonë kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeu kanë shkruar e botuar vepra letrare dinjitoze. Ndaj jo më kot artisti i madh dibran Bujar Kapexhiu – “Nderi i kombit” në çdo promovim do ta nisë fjalën e tij: DIBËR-LIBËR... Dhe Setki Jashari është njëri prej krijuesve dibranë që nderon Dibrën, familjen e tij, shoqërinë.

Këto ditë ai botoi librin e tij të katërt, romanin: “Meteori ndëshkues”, për të cilin Dr.Hajri Mandri, ndër të tjera vlerëson paraqitjen e momenteve psikomentale të fazës më të vështirë të tranzicionit shqiptar. Sipas redaktorit Mandri: “Personazhet që autori sjell në këtë vepër janë përfaqësues të veçantë të grupimeve shoqërore, në sjellje të përkundërta, në përplasje deri në konflikte të hapura dhe hakmarrjeje, si motive të dobëta shoqërore që prodhon konteksti social në tranzicion, sidomos kur shteti dobësohet dhe krimi e korrupsioni i mbivendoset sistemit ku grabitësit dalin në rrugë ditën për ditë. Dilemat dhe iluzione të ndryshme lindin në psikologjinë dhe mënyrën e të menduarit. Është një revolucion i vërtetë psikomoral që përfshinë shoqërinë, ndaj ngjarjet në roman janë mjaft intensive dhe me të papritura....”



KATËR VEÇORI NË POEZINË E S.JASHARIT

Veçanërisht, poezisë, autori Setki Jashari i është përkushtuar që në rininë e tij...Më së miri e profilizon atë si poet, gazetari, politologu dhe diplomati i mirënjohur Kamber Faruku, i cili si edhe qindra krijues dibranë, edhe Setkiun e ka evidentuar dhe promovuar që në vitet “80-të të shekullit të kaluar kur drejtonte sektorin e kulturës në gazetën “Ushtima e Maleve”.

Ndërsa nga parathënia ime për vëllimin poetik “Vegime dashurie”, folësit në këtë promovim vlerësuan identifikimin e katër veçorive në poezinë e Setki Jasharit: Poezi ku mbizotëron tema e dashurisë; Poezi ku shprehet krenaria kombëtare; Poezi me temë sociale dhe Poezi meditative-filozofike.

Këto veçori dalloheshin fare qartë edhe në poezitë që interpreton ikona e teatrit dhe kinematografisë shqiptare, diva e skenës Margarita Xhepa – Nderi i Kombit.

Veçoria e parë: Poezi ku mbizotëron tema e dashurisë Padyshim që në këtë vëllim me titullin sinjifikativ “Vegime dashurie”, shumica e poezive trajtojnë temën e dashurisë. Si të tilla ato përshkohen nga dashuria, një ndjenjë magjike kjo dhe e mrekullueshme.

Veçoria e dytë: Poezi ku shprehet krenaria kombëtare

Nëse në evente festive gjithkush ndjen krenari të ligjshme nga brohoritjet entuziaste “O sa mirë me ken’ shqiptar, o hej!!!”, autori i këtij libri, krenarinë për kombin e shpreh në vargje kup-timplotë si: “Asht një vend n’zemër t’Ballkanit/ Asht një vend në mes t’Evropës/ Asht një vend ma i bukuri i botës/ Sot e mot ka veç një emën/ E ka emnin “Shqipëri”... Padyshim kjo është një poezi që i përshtatet plotësisht potencialit jetësor të këtij autori. Këtu poeti i mbetet vetëdijshëm krenarisë kombëtare; Shqipëria është shënjtëria për të, që nuk e ndërron me asgjë tjetër.

Veçoria e tretë: Poezi me temë sociale Plagët sociale të një shoqërie në tranzicion zënë vend të veçantë në poezinë e Setki Q.Jasharit. Kështu, në poezitë e titulluara: “M’ka marrë malli, nanë”, “Sot jemi më keq se kurrë”, “Nuk ka ma keq”, “Ah pleqëria” etj, përveçohen dhe përçohen konceptet filozofike të këtij autori për vazhdimësinë e jetës, për familjen dhe shtetin e së drejtës.

Veçoria e katërt: Poezi meditative-filozofike Në vëllimin “Vegime dashurie” dallohen gjithashtu disa poezi meditative-filozofike. Kështu, nëse tek pezitë me tutull: “Sot fola me detin”, “Kafeneja e fshatit”, Reflektim dashurie” e “Çaste mër-zitë” ndeshim në karakterin meditativ (poeti mediton), në disa poezi të tjera si “Më mirë poet se sa mbret”, “Poeti dhe i marri”, “Poetët janë hyjnorë”, “Ku je fshehur Iz” dhe “Trishtimi i poetit”, evidentojmë qartë mendimin filozofik të këtij autori tashmë të sprovuar.

VENDLINDJA, FRYMËZIMI I PËRHERSHËM I S. JASHARIT

Për Setki Jasharin, frymëzim i përhershëm ka qenë vendlindja e tij, Maqellara. Ka shkruar shumë për të e për njerëzit e saj, si dhe për viktima të emigracionit klandestin e të trafikut njerëzor, ashtu siç i ka përjetuar gjatë viteve që ka kaluar si emigrant në Greqi e Itali, dhe po ashtu Ai ka kontribuar që për vendlindjen e tij të institucionalizohet një ditë feste – DITA E MAQELLARËS, e cila përshfaqej qartë dhe me nota optimiste në dokumentarin që çeli këtë festë të promovimit të katër librave të tij.

Falë mbështetjes së familjes së tij të mrekullueshme, bash-këshortës Liries, djalit Tarzanit (emigrant në Angli) dhe dy vaj-zave, Selira e Angjela, Setki Jashari i është përkushtuar totalisht procesit krijues, duke i dhënë lexuesit një produkt letrar cilësor në dy romane, një libër me novela e tregime dhe vëllimin me poezi “VEGIME DASHURIE”...

Këto katër libra janë dhurata më e mirë e Setki Jasharit për lexuesin në ditëlindjen e tij të 60-të, në vigjilje të së cilës e urojmë për zemërsisht:

Jetofsh mbi një shekull, më këtë vitalitet e shpirt krijues që keni aktualisht, me shëndet të plotë e mendje të kthjellët..dhe me lumturi pafund.

SA BUKUR ME QENË SHQIPTAR

Asht një vend n’zemër t’Ballkanit
Asht një vend në mes t’Evropës;
Asht një vend ma i bukuri i botës
Sot e mot ka veç një emën
E ka emnin “Shqipëri”...

Asht një vend ku lind shqiponja
Asht një vend ku rriten trima;
Asht një vend ku rriten zana
Sot e mot zemër bujari
E ka emnin, Shqipëri....

Sa e bukur vjen pranvera
Oh, sa bukur ndriçon Dielli...
Manushaqja çel ndër ferra
Çel mimoza, çel qershia
Sa e bukur asht, Shqipëria....

Oh sa vapë, ban në verë...
Freskon deti, joshën mali...
Piqet dardha, piqet mani
Korret jonxha, korret gruni
E pra, ky vend, që thua ti
E ka emnin, Shqipëri....

Sa lezet ka kur vjen vjeshta
Vilen mollët, vilen vreshta
Plot me djathë, mbushen vedrat
Plot me drithë, plot me turshi
Parajsa vetë është, kjo Shqipëri....

Pa vjen dimni plot lezet
Në oxhak vorba gërhet
Piqet gështenja, pastërmaja
Çahen arra, pihet verë e raki
Rrofsh e qofsh moj Shqipëri!

Bijt’ e shqipes kur martohen
Dhe perënditë në qiell gëzohen
Ka lezet vallja, ka lezet kënga
Jemi Kastriotas, jemi krenarë
Oh, sa bukur me qenë Shqiptar....

JU PRET SHQIPËRIA

O Zot! O perëndi!
Pse po vuan kjo shoqëri?
Qan flamuri, qan Shqipëria
Ikën djem, ikën bija...

Ku po ikni fëmijët e mi?
Pse po m’lini në vetmi?
Do të vdes pa ju parë
S’ka njeri t’më fusë në varr.

Kudo t’shkoni nëpër botë
Nuk do t’gjeni si kjo tokë,
Do të gjeni atje gjithçka
Nënë e babë, atje nuk ka...

Do të lozni do të qeshni
Por atdhenë mos e shani!
Ç’ju do barku do të hani
Por atdheun mos e harroni!











Mos harroni babë e nënë!
Se dhe ju do t’ju përzënë
Mos harroni, o djem e bija!
Sot e mot ju pret Shqipëria.

Sugjerime librash

BOTIME M&B

069 20 68 603 (Viber).
068 65 08 441 (WhatsApp).

mbbotime@gmail.com
botimemb@gmail.com



Porositeni pranë librarisë në lagjen tuaj ose përmes telefonit. Posta brenda Shqipërisë është falas.